

Efiçienca e buxhetit të Bashkisë Mirditë (Viti 2020)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2020

Studimi ka për qëllim të analizojë efiçencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2020, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

Burimet e financimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë)	209,191	2,030,981	49 %
Transferta e kushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar)	35,270	342,427	8 %
Transferta specifike	142,609	1,384,553	33 %
Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë)	43,455	421,893	10.1 %
TOTALI	430,525	4,179,854	100 %

Burimi: Bashkia Mirditë (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Mirditë 2020



Burimi: Bashkia Mirditë (Ilogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Mirditë për vitin fiskal 2020

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2020. Më poshtë po japim tabelën përmbljedhëse të shpenzimeve:

Tabela 2. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

Emërtimi i shpenzimit	(Vlera në 000 Lekë)	(Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë	% mbi totalin e të ardhurave
Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore	245,966	2,388,019	57.1
Shpenzime Korrente	79,913	775,854	18.6
Shpenzime Kapitale	104,646	1,015,981	24.3
TOTALI	430,525	4,179,854	100 %


Burimi: Bashkia Mirditë (Ilogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale



Burimi: Bashkia Mirditë (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Mirditë (llogaritje EIC)